



---

**KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE**

Nr 359 prot

Tiranë, më 25.10. 2023.

**VENDIM**

Nr. 5 datë 25.10 2023

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 5/10/2023**

Këshilli Konsultativ, bazuar në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Vendimin Nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për çështjet, objektet konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, objekt konsultimi në mbledhjen e datës 5/10/2023 vendosi:

1. Për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime" në Ligjin nr.107 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", propozuar nga Ministria e Brendshme anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Neni 4 pika 1, të sqarohet përkufizimi për "akte normative", pasi është e përcaktuar qartë në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, pasi urdhri është kryesisht akt individual dhe si rregull lëshohet nga organet individuale jo kolegjiale;
- Neni 7 pika 6, neni 10 pika 4, ku citohet "Planet e veprimit me masat përkatëse në rast organizimesh sportive, kulturore hartohen në konsultim dhe dakordësi...", të riformulohet si vijon; "Planet e veprimit me masat përkatëse në rast organizimesh sportive, kulturore në nivel qarku hartohen në konsultim dhe dakordësi..." me qëllim shmangien e papajtueshmërive me Nenin 25, pika 4 dhe neni 13, pika 1 të Ligjit 139 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Pika 4 pas gërmës "c", ku citon "Prefekti koordinon procesin e grumbullimit të të dhënave për Sistemin e Monitorimit të Performancës së Shërbimeve Publike..." të riformulohet si vijon; "Prefekti koordinon procesin e grumbullimit të të dhënave në nivel qarku për Sistemin e Monitorimit të Performancës së Shërbimeve Publike...";

- Pika 4 pas gërmës “c” paragrafi i dytë “Raporti vjetor i performancës së shërbimeve publike të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore është subjekt i verifikimit të të dhënave nga Prefekti”, duhet saktësuar termi “verifikon të dhënat”, sepse lë hapësirë për debate dhe konflikte ndër-institucionale;
- Neni 11 pika 2 gërma “v”, parashikohet se “në rastet kur akti i depozituar te prefekti i qarkut nuk është me karakter normativ, prefekti i qarkut nuk shprehet për ligjshmërinë e tij, por e kthen atë”. Shprehja “por e kthen atë” duhet hequr sepse krijon idenë e mosmiratimit dhe të formulohet “nuk shprehet për ligjshmërinë” ose të shtohet “kërkesë për rregullim, korrigjim”.
- Neni 16 pika 1, pas të cilës shtohet pika 1/1 me përmbajtje “...Në zbatim të përgjegjësive të këtij ligji, prefekti i qarkut nxjerr urdhra për grupe pune të përbashkët të administratës së tij dhe inspektoriateve në qark sipas rastit për verifikimin e shkeljeve të pretenduara në ankesat ndaj subjekteve publike apo private në qark...”, të riformulohet duke shtuar “...dhe inspektoriateve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Neni 10 pika 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh”, duhet të formulohet: “kërkon nga institucionet qendrore në nivel vendor dërgimin e planit vjetor të punës, si dhe një raport të hollësishëm mujor për realizimin e tij, përfshirë informacione për treguesit e performances dhe problematikat e hasura;
- Në nenin 23 bëhen këto shtesa dhe ndryshime; Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 si vijon. “Nënprefekti zëvendëson prefektin”, sipas Kodit të Procedurave Administrative ky ndryshim duhet të bëhet tek neni 22 “Nënprefekti”, pas pikës 1 shtohet pika 1.1;
- Neni 3 pika 5, shkronja (m) shton kompetencën e Prefektit të Qarkut për ti propozuar Ministrin Përgjegjës për Çështjet Vendore shkarkimin e kryetarit të bashkisë, dispozite e cila parshikohet në nenin 62 të Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili parashikon specifikisht rastet e shkarkimit të kryetarit të bashkisë;
- Neni 3 pika 4, parashikon shtimin e kompetencave të prefektit të qarkut me “marrëveshje të veçanta” lë shkak për abuzim duke shtuar kompetenca që ligji nuk i njez por vijnë për shkak marrëveshjes duke specifikuar llojin e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- Neni 3 pika 5, lidhur me kompetencën për monitorimin e projekteve/programeve në nivel qarku, të shihet i lidhur edhe me programet e financuara nga Fondi Social në përputhje me VKM nr. 150/2018 dhe Ligjin 121/2016;
- Neni 10 pika 3, parashikohet raportimi për efekt të marrëdhënieve të prefektit me institucionet qendrore në nivel vendor (nuk janë në varësi të prefektit të qarkut, por të titullarit të institucionit apo ministrit përgjegjës), nuk parashikohet monitorimi i veprimtarisë së tyre.
- Neni 12 pika 3, ku citon “Prefekti i Qarkut kërkon dhe merr rregullisht informacion nga Drejtori i Policisë Vendore për problemet e rendit”, duhet të shkrihen dispozitat në një të vetme meqenëse ka mbivendosje dhe qëllimi është i njëjtë;
- Neni 10 sipas të cilit Prefekti i Qarkut kryen veprimtari monitorimi të NJVV del jashtë kompetencave të tij dhe nuk është në përputhje me ligjin për NJVV, si “Raporti vjetor i performancës së shërbimeve publike të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore është subjekt i verifikimit të të dhënave nga Prefekti”;
- Neni 2 pika 3, shkronja (c) pas fjalës “të ketë” shtohet fjala “të paktën”, hiqet fjala “5 vjet” dhe zëvendësohet me fjalën “6 vjet” të bëhet 10 vjet pune dhe pa ndërprerje në administratën publike dhe shkronja (dh) “të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të shtohet “në zbatim të ligjit të dekriminalizimit”;
- Neni 3 gërma (l) “sinjalizon institucionet përgjegjëse inspektuese duke propozuar fillim të procedurës së inspektimit për shkeljet e evidentuara”, është një mbivendosje me autoritetet e tjera që kanë përgjegjësinë për të monitoruar këto fonde të kushtëzuara;

- Neni 7 pika 6, “Planet e veprimit me masat përkatëse në rast organizimesh sportive, kulturore hartohen në konsultim dhe dakordësi me strukturat e emergjencës së prefektit të qarkut”, e cila duhet dakordësi me NJVV dhe jo me prefektin;
  - Neni 11 pika 2, pas fjalës “ligjshmërisë” shtohet togfjalëshi “së formës dhe përmbajtjes”, të behet një model unifikues kombëtar mbi formën e aktit që prodhon NJVV, ndërsa përmbajtjen e përcakton vet bashkia;
  - Në pikën 1 parashikon që në shkronjën (a), pas fjalës “ligjshmërisë” të shtohet togfjalëshi “së formës dhe përmbajtjes”. Të përkufizohet saktë togfjalëshi “verifikim i ligjshmërisë” me qëllim që të mos tejkalohet kompetenca veçanërisht në lidhje me përmbajtjen, ndaj togfjalëshi “së formës dhe përmbajtjes” është i panevojshëm dhe do të rriste abuzivitetin gjatë procesit;
  - Pika 5 gërma (k), fjalia “...monitoron zbatimin e projekteve, programeve sektoriale në qark...” të riformulohet “...monitoron zbatimin e projekteve, programeve sektoriale në nivel qarku...”, pasi zbatimi i projekteve dhe programeve sektoriale janë të aplikueshme në bashki/qark referuar përcaktimeve të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
  - Pika 5 gërma (k), “... monitoron zbatimin e projekteve sektoriale në qark, që zhvillohen me fonde të kushtëzuara apo fonde të qeverisë qëndrore, veçanërisht përta i përket respektimit të afateve dhe cilësisë...” të rishikohet në përputhje me parashimet e nenit 13 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), për shmangien e papajtueshmërive. “Mbikqyrja dhe kontrolli” i afateve dhe cilësisë së punimeve të kontraktuara nga organet e qeverisjes vendore, sipas Ligjit “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në Republikën e Shqipërisë” bëhen nga supervizori dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.
  - Pika 5 gërma (ll), citon “...jep çertifikata nderi për persona me kontribut të veçantë në qark...” është e kompetencë dhe drejtë ligjore e Njësisë të Vetëqeverisjes dhe organeve vendimarrëse të njësisë, referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 1.7 të nenit 9, nenit 54 dhe 77 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), dhe nenit 9 “Titulli “Qytetar Nderi”, nenit 10 “Tituj e veçantë vendor” të Ligjit nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit”.
  - Pika 5 gërma (m), “propozon pranë Ministrisë Përgjegjëse për Çështjet Vendore shkarkimin e kryetarit të bashkisë pjesë e qarkut përkatës në rast të kryerjes së shkeljeve të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve” si një kompetencë e këshillit të bashkisë dhe nuk është në koherencë me Kartën për Autonomi Vendore, me parimin e pavarësisë së pushteteve.
2. Për projektvendimin **“Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujq Erzen”** propozuar nga Kryeministria, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore (AMBU), mbështetur në mendimet e tyre, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim
- 
3. Për projektvendimin **“Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujq Ishëm”** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, propozuar nga Kryeministria, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore (AMBU), mbështetur në mendimet e tyre anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
- 
4. Për projektvendimin **“Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor”** propozuar nga Ministria e Kulturës, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
    - Pika 6 citon “Institucionet e parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi shqyrtojnë kërkesën”, ndërkohë që pika 3 nuk parashikon asnjë nga këto institucione, por referon tek neni 16/1 i Ligjit. Pika 6 mund të referojë direkt tek institucionet sipas pikës 16/1 të ligjit si dhe për pikën 11 dhe 13;

- Pika 12, të harmonizohet me nenin 75/2 të Ligjit lidhur me kriteret për përcaktimin e shumës për kompensim të drejtë;
  - Pika 16 parashikon të drejtën e ankimit gjyqësor lidhur me masën e kompensimit duke shmangur ankimin administrativ, kështu që në reflektim të Kod.Proc.Adm. kjo pikë duhet të riformulohet për të dhënë mundësi autorit apo bashkëautorit të veprës të paraqesin ankim administrativ më parë;
  - Pika 4 të shtohet dhe një gërmë;
  - e) me vendim gjyqësor, për arsye se ndodh që mund të mos vertetohet me dokument sipas pikës (b), por bazuar në rrethana dhe fakte që gjykata mund ta vertetojë;
  - Pika ku citohet "autori i paraqet kërkesë institucioneve sipas pikes 1 të nenit 16/2 të Ligjit "Për të drejtën e autorit", të korrigojë pasi neni 16 i Ligjit 35/2016 "Për të drejtën e autorit" nuk përcakton institucionin ku duhet bërë kërkesa.
5. Për projektvendimin **"Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimet 2024-2030, të planit të veprimit si dhe pasaportës së tregueseve"** propozuar nga Ministria e Drejtësisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të përcaktohen në ligj rolet e secilit institucion, mbrojtjen dhe përkrahjen konkrete të viktimës si dhe buxhetimin e institucioneve, në rastin e viktimave të dhunës (gra dhe fëmijë), apo rastet e përdhumeve si dhe të kostohen në Planin e Veprimit përgjegjësive të NJVV për pikat 3.1.6.4, pika 3.3.2.1, pika 3.3.2.2, si dhe në masat për mbrojtjen e viktimave të krimet duhet të përfshihen edhe NJVV.
6. Për projektvendimin **"Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, në fushën e ndërtimit"** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Nenin 3, lidhur me Komisionin dhe Sekretariatit duhet që të dy organet të klasifikohen njëjloj;
  - Neni 6, "Konflikti i interesit", të rregullohen edhe elementë të tjerë që lidhen me pasojat në vendimmarrje të anëtarit që nuk deklaroi konfliktin e interesit dhe vendimet e tij të konsiderohen të pavlefshme dhe anulohen;
  - Neni 7 paragrafi 2 dhe 3, kanë mospërputhje lidhur me afatet, ku VKM parashikon në të njëjtën dispozitë se organet e ngarkuara duhet të caktojnë përfaqësuesit në komisionin disiplinor brenda 10 ditëve nga data e kërkesës së përcjellë nga ministria përgjegjëse për ndërtimin, ndërsa në pikën 1, të nenit 7, kreu II, të kësaj rregulloreje, përcaktohet brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
  - Neni 13 pika 3, mbi vendimmarrjen e ministrit në shkronjën (b) është problematike në termat ligjor dhe standardeve ndërkombëtare, pasi vendimi kthehet sërish për t'u shqyrtuar nga i njëjti komision që ka marrë vendim për procedimin/vendimin ndaj te cilit është bërë ankesa;
  - Neni 7 pika 1, ku specifikohet përbërja e Komisionit, gërma (d) "një përfaqësues nga Shoqata e Bashkive" të riformulohet specifikisht "një përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore".
7. Për projektvendimin **"Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87 datë 14.2.2018 "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare"**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.

8. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.686 datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;

- Pika 1 shkronja (j), “informacioni për marrëdhënien me tokën.... duhet të qartësohet nga cili organ jepet, bashkia, kadastra, ministria e bujqësisë apo....”;
- Pika 4.2, Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet të njoftojë njeherësh edhe bashkinë;
- Pika 5, “për vlerësimin e drejtë të dokumentit” nga bashkia, afati duhet të jetë të paktën 7 ditë kalendarike;
- Pika 1.2, ku parashikohet vetëm nënshkrimi elektronik i raportit të VNM, duhet të vendoset edhe mundësia e nënshkrimit me shkrim, konform legjislacionit në fuqi.
- Pika 3 e ndryshuar, të përcaktohet afati lidhur me verifikimin e dokumentacionit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

**Z. Arbjan MAZNIKU**  
Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor  
Bashkëkryetar

**Z. Aldrin DALIPI**  
Kryetar i Shoqatës së Këshillit  
të Qarqeve të Shqipërisë  
Bashkëkryetar